



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja  
Nauke i Inovacije/ Ministry of Education, Science and Innovation*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 013/303  
Datë: 13.07.2022

Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 8 pika 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 2/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

#### V E N D I M

**Për ndarje të bursave për nxënës në IAAP në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtimet teknike**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ( MASHTI) për vitin e ri shkollor 2022-2023 ndan bursa për nxënësit e IAAP-ve për klasën e 10-të.
2. Vlera e bursës për nxënës është 50 euro në muaj (përveç muajt korrik dhe gusht), përkatësisht 500 euro për një vit shkollor.
3. Numri i bursave është 40, në drejtimet deficitare 20 dhe për vajza në drejtimet teknike 20.
4. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve, ndërsa, për drejtimet teknike vetëm vajzat.
5. Bursa për drejtimet deficitare:
  - Teknik për dizajnin e mediave interaktive
  - Instalues elektrik
  - Veterinë
  - Mekatronikë
  - Asistent i turizmit dhe udhëtimeve
  - Automekanik
  - Hortikulturë

6. Bursat për vajza në drejtimet teknike:
- Metalpunues
  - Instalues elektrik
  - Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit
  - Automekanik
  - Teknologjia e riciklimit
  - Energjetikë

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), duke pas parasysh nevojat e tregut të punës, në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe stimulimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe vajzave në drejtimet teknike për vitin shkollor 2022-2023, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të përgjithshëm,
3. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP);
4. DAAP;
5. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
6. Arkivit.

